

ART DHE STOLI SHQIPTAR

"PASIONI PRIMORDIAL"



Në një treg global ku mbizotërojnë vlera dhe tendenca komerciale, dhe ku infrastruktura promovuese shpesh mbështet dhe zhvillon shije që rrafshojnë identitetet në funksion të shkrijës së elementeve globaliste, është një sfidë e vërtetë të dalësh në pah dhe të konkurrosh denjësisht duke evokuar vlerat artistike të traditës dhe historisë kombëtare, duke sjellë njëkohësisht edhe risi profesionale dhe estetike. Një shtysë për këtë refleksion është krijimi më i ri i një ore unike shqiptare, rezultat i pasionit dhe punës pesëvjeçare!

Ora "PASIONI PRIMORDIAL", titulluar kështu nga vetë krijuesi i saj, "Pirro Ruço".

Kjo vepër paraqet dymbëdhjetë valltarë shqiptarë, një simbolikë përfaqësuese e unitetit të krahinave shqiptare të pasqyruara në mikro-figurina plot ngjyra. "Pasioni Primordial" është një arritje e artit kinetik bifunksional, realizuar me mjeshtëri të lartë që përfaqëson një simbiozë të përsosur mes teknikës së avancuar dhe estetikës klasike tradicionale. Punimi përfshin një dizajn të pasur me detaje të hollësishme që bazohen në njohuri historike të kostumografisë dhe rekuizitës, duke shpalosur një skenë të pasur simbolike nga folklori kombëtar. Në qendër të orës, e cila ngjan me një skenë amfiteatri, brenda kupolës së saj transparente vallëzojnë figurat në miniaturë, ku secila prej tyre është e modeluar imtësisht me një lartësi prej 9-10mm, duke ruajtur karakterin e secilës prej tyre. Figurat vallëzojnë rreth një ansambli simbolik shqiptonjash të stilizuara, ndërmjet krahëve të të cilave qëndrojnë muzikantët që luajnë me instrumentet e tyre. Figurat brenda kupolës së qelqtë janë formësuar me detaje të jashtëzakonshme, veshjet tradicionale dhe ekspresioni i tyre plot gjallëri, që të sjell ndërmend festat dhe ritualet tradicionale kombëtare. Ora është formësuar nga materiale të vyera, me një bazë të mozaikuar me gradient ngjyrash të kuqe dhe të zezë me "gurë" prej qelqi Murano, gjithsej janë 1500 gurë në tetë tonalitete të ndryshme dhe 64 prerje, me më të voglën që mat vetëm 0.2mm. Mbulesa e pasme pasqyron sërish në relief skenën e përparme me valltarët në

mikro-reliev. Kasa unike me detaje e bën këtë orë jo vetëm një instrument të matjes së kohës, por edhe një vepër shpirtërore dhe filozofike.

Për shqiptarët, "Pasioni Primordial" është më shumë se një orë; ajo është një simbol shpirtëror dhe identitar që vjen si lajmëtar i kohës së shqiptarëve në shekullin XXI. Ajo promovon kulturën dhe traditat. Skena e vallëzimit përfaqëson lidhjen e ngushtë kulturore mes njerëzve për ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar. "Pasioni Primordial" sjell në jetë historinë dhe traditën përmes dizajnit të shkëlqyer dhe teknologjisë së avancuar. Ajo është një dëshmi për dashurinë, vlerat dhe pasionin që qëndrojnë pas krijimit të çdo detaji të saj, duke e bërë atë një vepër të vyer për çdo koleksion, dhe duke e veshur atë me petkun e kohës, pa humbur peshën artistike dhe pa rënë në folklorizëm amator.

Marka shqiptare me emrin mbretëror "Pirro", emër të cilin mban vetë krijuesi i saj, ka arritur të ruajë, promovojë dhe avancojë trashëgiminë e pasur dhe të lashtë iliro-arbërore-shqiptare. Duke përfshirë një spektër të gjerë punimesh, pikërisht marka shqiptare "PIRRO" ka marrë përsipër këtë sfidë duke ruajtur, promovuar dhe sjellë në kohë trashëgiminë e pasur të stolive të lashta iliro-arbërore-shqiptare, me përkushtim dhe krijimtari të jashtëzakonshme. Pirro është njohur për krijimin dhe realizimin e një game të gjerë teknikash dhe realizimesh si bizhuteri, medalje, relieve të monedhave, figura, skulptura miniaturë dhe vepra në filigram, që mbajnë shpirtin dhe traditën shqiptare të gjallë, duke i

risjellë në jetë krijesat dhe dizajnet që datojnë nga koha e ilirëve të lashtë deri në ditët tona moderne. Çdo vepër e krijuar nga kjo markë apo "qendër kulturore", është një artefakt i vyer dhe denjësisht i trashëgueshëm, duke përfaqësuar një pjesë të rëndësishme të historisë dhe kulturës shqiptare. "Artistic Jewellery Pirro" është një emër që ka fituar respekt dhe vlerësim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u bërë një promovuese e kulturës së lashtë shqiptare në botën moderne. Në nivel kombëtar, Pirro ka kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e kulturës shqiptare, ndërsa në arenën ndërkombëtare, ky emër ka përfaqësuar Shqipërinë në evenimente prestigjioze, ku është vlerësuar për dizajnet unike dhe cilësinë e lartë të punimeve me teknologji novatore. Një konkurrent dhe sfidues për brendet e mëdha ndërkombëtare, kjo ka bërë që emri të njihet dhe të respektohet nga ardashës dhe koleksionistë në trojet shqiptare dhe në mbarë botën. E veçanta e kësaj marke qëndron në angazhimin për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë e ilirëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotëm. Ajo që në fakt duhej të bëhej nga institucione të posaçme shtetërore dhe publike! Çdo vepër apo stoli e markës PIRRO mban aroma dhe nuanca nga motive dhe simbole të lashta, të cilat janë studiuar dhe riprodhuar me shumë finesë dhe kujdes. Ky përkushtim për unikalitet dhe cilësi ka bërë që PIRRO të konsiderohet si një trashëgimtarë i denjë i traditave të lashta, duke i sjellë ato në modernitet dhe bashkëkohësi.

"Artistic Jewellery Pirro" nuk është thjesht një markë, por është kthyer në një institucion që ruan dhe transmeton një pjesë të rëndësishme të historisë dhe kulturës shqiptare. Duke krijuar vepra dhe stoli me plot histori që janë njëkohësisht të bukura dhe të mbushura me shpirt dhe energji, Pirro ka ndërtuar një urë shpirtërore mes së kaluarës dhe të ardhmes. Përmes punës së palodhur dhe përkushtimit ndaj cilësisë dhe autenticitetit, "Artistic Jewellery Pirro" është kthyer në një simbol krenarie kombëtare dhe një përfaqësuese trashëgimtar i kulturës së lashtë ilire për krijimin e stolive me histor simbolei dhe legjenda që shpirtëzohen në vepra të përjetshme dhe shenja qytetërimi e identiteti. Këto tashmë mbajnë markën "Made in Albania". Në këtë mënyrë, jo vetëm që ruhet një trashëgimi e vyer, por e bën atë të jetojë dhe të ndriçojë në kohët moderne.